



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.750/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Ahmet Rexhaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve: V. Z, E. Z që të dy nga Peja për shkak se në bashkëveprim kanë kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1 nën par 1.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, dhe të akuzuarit A. S nga Peja për shkak se ka kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1 nën par 1.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP.II.nr-1250/13 të datës 26.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarve V. Z, E Z dhe A S, si dhe pala e dëmtuar D. S, me datë 11.10.2017 mori dhe shpalli si dhe me datë 30.10.2017 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari V Z i biri i E dhe i nënës S e gjinisë M i lindur me datë, në Pejë, ku edhe jeton, rruga “B e K” nr. ..., ka të kryer shkollën, i, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.
2. I akuzuari E Z i biri i B dhe i nënës E e gjinisë M i lindur me datë ... në Pejë, ku edhe jeton, rruga “B e K” nr. ..., ka te kryer shkollën....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.
3. I akuzuari A S i biri i J i nënës T i gjinisë Th, i lindur me datë në Pejë, ku edhe jeton, rruga “H S Q” i pashqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Për shkak se:

Të akuzuarit V. Z dhe E. Z

Me datë 12.08.2013 rreth orës 12:45 min, në rrugën “H S Q” Pejë, pikërisht para hyrjes së shtëpisë së tyre, me dashje i kanë shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit D S, më atë mënyrë që, për shkak të disa mosmarrëveshjeve të mëhershme në mes të pandehurve dhe familjes S fillimisht i pandehuri V me tu takuar në vendin e lartcekur me të dëmtuarin Dardan, i drejtohet të dëmtuarit me fjalët “kopil, kur foli me ty kqyrëm në sy” më pas e kap për dore dhe ndalon të njëjtin duke e goditur me grusht në fytyrë, ku dhe vazhdon përleshja, me çrast nga oborri i shtëpisë del dhe i pandehuri me një shufër metalike në duar me të cilën e godet të dëmtuarin në pjesë të ndryshme të trupit, ku me pas dhe i pandehuri V merr një shufër druri (bisht fshise) dhe përsëri e godet të dëmtuarin në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit, përderisa i dëmtuari D më zë të lartë e thërret në ndihmë vëllain e tij i cili në atë moment ishte në shtëpi (komshinjë), nga oborri i shtëpisë së të pandehurve del i pandehuri T i cili po ashtu në duar mbante një shufër metalike me të cilën e godet të dëmtuarin në fytyrë dhe pjesë të ndryshme të trupit, me çrast që të tre të pandehurit i shkaktojnë lëndime trupore dhe atë ndrydhje të indeve të buta të kokës dhe kërdhokut të syrit, ënjtje të indeve të buta me gjakmbledhje përreth syrit të majtë grumbullim gjaku në kërdhokun e syrit dhe plagë çarës-shquese të indeve të buta në këndin e jashtëm të syrit të djathtë,

-Me çka në bashkëveprim kanë kryer vepër penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par. 1 nënpar.1.1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

I akuzuarit A. S

Për shkak se:

Me datë 12.08.2013 rreth orës 12:45 min, në rrugën “H S Q” Pejë, në afërsi të hyrjes së shtëpisë së tyre, me dashje u ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarve T. Z dhe V. Z, në atë mënyrë që, përderisa këtu dëmtuarit kishin qenë duke u përleshur me dëshmitarin D.S, ku ky i fundit e thërret në ndihmë vëllain e tij këtu të pandehurin A, i cili me një thikë rreth 20.05 cm në dorë i afrohet vendit të ngjarjes dhe përderisa sheh se të dëmtuarit ia kishin sulmuar vëllaun dhe po e rrihnin, i pandehuri fillimisht gjestikulon me thikë në dorë me qëllim të frikësimit e më pas po ma atë thikë e godet të dëmtuarin V dy herë në këmbë, me çrast reagon i dëmtuari T duke dasht ta godas të pandehurin, ku ky i fundit me po të njëjtën thikë e godet edhe të dëmtuarin T në këmbë në pjesën e gjurit, me çrast iu ka shkaktuar lëndime trupore dhe atë të dëmtuarit T Z, plagë prerëse të indeve të buta në regjionin e gjurit dhe këmbës së majtë, dhe të dëmtuarit V Z, plagë prerëse të indeve të buta në regjionin e vidhës (mollaqës) së këmbës së djathtë dhe kofshës së këmbës së djathtë,

-Me çka ka kryer vepër penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par. 1 nënpar.1.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7,41,42,49,50,51,52,73, të KPK-së, neni 188 par.2 lidhur me par. 1 nënpar.1.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarve V. Z, E. Z dhe A. S iu shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit V. Z i përcaktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari V. Z që në emër të shpenzimeve të procedurës penale t'ia paguaj gjykatës shumën prej 50€ dhe paushall gjyqësor shumën prej 20€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ashtu që të akuzuarit E. Z i përcaktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari E. Z që në emër të shpenzimeve të procedurës penale t'ia paguaj gjykatës shumën prej 50€ dhe paushall gjyqësor shumën prej 20€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ashtu që të akuzuarit A S përcaktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari A S që në emër të shpenzimeve të procedurës penale t'ia paguaj gjykatës shumën prej 50€ dhe paushall gjyqësor shumën prej 20€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, ka ngrit aktakuzë PP.II.nr-1250/13 të datës 26.10.2015, kundër të akuzuarve : V. Z, E. Z që të dy nga P. për shkak se në bashkëveprim kanë kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1 nën par 1.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, dhe të akuzuarit A. S nga P. për shkak se ka kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1 nën par 1.1 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP.II.nr-1250/13 të datës 26.10.2015, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarve iu ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarit për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari V. Z ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, I akuzuari E. Z ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe i akuzuari A S ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë dhe se e pranon fajësinë sa i përket asaj që e ngarkon aktakuza gjegjësisht dispozitivi i dytë i aktakuzës.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se meqenëse të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë secili veç e veç për veprat penale për të cilat akuzohen, dhe meqenëse një pranim nga ana e tyre është i bazuar edhe në provat në bazë të të cilave është ngritur aktakuza i propozon gjykatës që ta pranoj fajësinë.

Pala e dëmtuar D. S ka deklaruar sesa i përket ndjekjes penale ndaj të akuzuarve të lartcekur ia lë në kompetencë gjykatës për vendosje dhe nuk prashtron kërkesë pasurore juridike-kompensim dëmi.

I akuzuari V. Z meqenëse është edhe palë e dëmtuar në këtë çështje juridiko penale ka deklaruar se sa i përket ndjekjes penale ndaj të akuzuarve A. S ia lë në vendosje gjykatës dhe nuk kërkon kompensim dëmi.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarve, pasi që ata e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse të akuzuarit secili veç e veç kanë pranuar fajësinë për veprat penale të cilat iu vihen në barrë sipas aktakuzës, e meqenëse një pranim nga ana e tyre është i bazuar edhe në provat tjera në bazë të cilave është ngritur aktakuza, prokurores së shtetit nuk i mbetet asgjë tjetër, dhe mbetet në tërësi pranë aktakuzës, përshkrimit, faktit juridik të veprës penale, i propozon gjykatës që të njëjtit veç e veç të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, po ashtu të obligohen edhe në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale. Me rastin e marrjes së vendimit mbi

dënim i propozon gjykatës si rrethanë lehtësuese për të gjithë të akuzuarit gjykata të ketë parasysh pranimin e fajësisë, fakti se ka kaluar një kohë e gjatë nga momenti kur është kryer vepra penale që nga viti 2013, dhe nga kjo kohë nuk ka pasur probleme me këto dy familje në mes veti. Rrethana renduese prokurorja e shtetit nuk ka gjetur.

I akuzuari V. Z në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fajësinë e ka pranuar vullnetarisht edhe pasi që e ka pranuar fajësinë, i propozon gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese, premton se nuk do ti përsëris në të ardhmen veprat e tilla apo të ngjashme, duke deklaruar para gjykatës se është penduar, dhe në bazë të këtyre rrethanave kërkon nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim ti ketë parasysh si rrethanë lehtësuese, meqenëse në këtë proces është edhe palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, ashtu siç ka deklaruar edhe më larë në këtë shqyrtim gjyqësorë.

I akuzuari E. Z në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm me të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë, këtu me të dëmtuarin A. S janë komshinj dhe nga koha kur ka ndodhur rasti në vitin 2013 nuk i kanë raportet e acaruar në mes veti, publikisht para gjykatës deklaroi se veprimet të cilat kanë ndodhur ditën kritike nuk do të përsëriten, të cilat nuk është dashur të ndodhin, është penduar për atë çka ka ndodhur e duke pasur parasysh të gjitha këto si dhe pranimin e fajësisë i kërkon gjykatës që ti merr si rrethanë lehtësuese në rastin e marrjes së vendimit mbi dënim.

I akuzuari A. S në fjalën përfundimtare ka deklaruar se që në shqyrtimin e parë fillestar e ka pranuar fajësinë, këtë e ka bërë në mënyrë të vullnetshme pa ndikim nga askush, pasi që gjyqtari i çështjes e ka njoftuar me pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, është e vërtet që ngjarja ka ndodhur në vitin 2013 dhe nga ajo kohë nuk kanë probleme më në mes veti, janë pajtuar, dhe i premton gjykatës se nga ana e tij dhe familjareve të tij nuk do të ketë më probleme në të ardhmen, me fqinjët e tyre këtu E dhe V. Z, andaj duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana kërkon nga Gjykata që ti ketë parasysh si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, duke potencuar se ditën kritike veprimin inkriminues e ka kryer në afekt, dhe nuk ka qenë në gjendje për të kontrolluar veprimet e tij, për çka është penduar dhe kërkon falje publikisht palës tjetër dhe palëve të dëmtuara dhe të akuzuarve me të cilët është përfshirë në kryerjen e veprës penale për të cilët është akuzuar.

Pala e dëmtuar D. S në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë deklarimeve të mësipërme, pajtohet plotësisht me fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike për kompensimin e dëmit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: ekspertiza mjeko ligjore e dt. 25.11.2013, e përpiluar nga Dr.F D, ekspert i licencuar, raporti i policit F. M. i dt. 12.08.2013, deklarata e të pandehurit A. S. e dhënë në stacionin policor me dt. 12.08.2015, dhe në Prokurorinë Themelore në Pejë me dt. 18.04.2015, deklarata e

dëshmitarit F Z e dhënë në stacionin policor me dt. 12.08.2013, deklarata e të pandehurit V Z e dhënë me datën 13.08.2015 në Stacionin Policor në Pejë, në Prokurorinë Themelore në Pejë me datën 14.03.2015, deklarata e të pandehurit T Z e dhënë në Stacionin Policor me dt. 13.08.2015 dhe në PTH në Pejë me dt. 14.03.2015, deklarata e të pandehurit E Z e dhënë me dt. 13.08.2015 në Stacionin Policor në Pejë dhe në PTH në Pejë me datën 14.03.2014, deklarata e dëshmitarit K Z e dhënë me datën 12.08.2015 dhe në PTH në Pejë me datën 14.03.2014, deklarata e të dëmtuarit D S e dhënë në stacionin Policor n]me dt. 12.08.2015 dhe në PTH në Pejë me dt. 10.03.2014, deklarata e dëshmitarit A R e dhënë në stacionin policor me dt. 12.08.2013 dhe në PTH në Pejë me dt.18.04.2014, deklarata e dëshmitares A I e dhënë në stacion policor me dt. 12.08.2013, fotoalbumi nga forenzika me numër të dosjes së forenzikës 0660-2013, lista e dëshmive nga Njësia e Forenzikës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e kanë pranuar fajësinë qysh në fillim, patën sjellje korrekte në shqyrtim gjyqësor, iu kanë kërkuar falje palëve të dëmtuara, për gjykatën nuk ka të dhëna se të njëjtit kanë ra ndesh me ligjin më parë, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarit e lartcekur gjykata nuk ka gjete asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarën e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, i obligoi të akuzuarit e lartcekur që secili veç e veç ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit i obligoi të akuzuarit që secili veç e veç ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm,
P.nr.750/15, me datë 30.10.2017.**

Bashkëpunëtore profesionale
Besa Dervishaj

GJ Y Q T A R I
Ahmet Rexhaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.